



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Komuna e Kaçanikut**  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

**01Nr.104/02-16334**

## **PROCESVERBAL:**

Dëgjim buxhetor:

Buxhetin për vitin 2024 dhe planifikimet për vitet 2025-2026 me sektorin e shëndetësisë

Data: 27.07.2023

Vendi: QKMF- Kaçanik

Ora: 11:00

Komuna e Kaçanikut përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa e cila ka hartuar draft buxhetin për vitin 2024, duke u bazuar në ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, dhe nenin 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, organizoi dëgjim buxhetor me sektorin e shëndetësisë.

Fillimisht takimin e hapi Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Sali Malsiu, i cili përmendi shifrat e buxhetit të ndara për shëndetësi, ndërsa shtoi se shuma e caktuar për investime komunale ende nuk është specifikuar se ku do të shkojë, për shkak të marrjes së kërkesave nga dëgjimi publik.

**Sinan Zenenli**- Drejtor i QKMF-së- përgëzoi komunën për arritjet e deri tashme në shëndetësi, ku përmendi shtimin e numrit të stafit mjekësor si dhe investimet kapitale. Ai kërkoi mirëmbajtje të objekteve, të shtohen shërbimet si në gjinekologji dhe radiologji, si dhe ta kompletojnë QKMF-në me të gjitha shërbimet e nevojshme mjekësore.

Arben Koxha- Laborant- të ketë më shumë laboratorë edhe nëpër AMF, të aktivizohet laborator i edhe në Doganaj. Poashtu kërkoi që të bëhet dezinfektimi dhe dezinfektimi i hapësirave publike.

**Lulzim Hoxha-** Specialist i Urgjencës- Të furnizohemi me një aparat për troponinë për urgjencë, një veturë për rastet paliative, të rregullohet apo të forcohet sistemi i internetit brenda objektit të QKMF-së.

**Nexhat Zharku-** Shef i autoparkut- Të rregullohet garuzhda, me vetura jemi keq, sektori i vaksinimit dhe pothuajse të gjithë sektorët, edhe drejtorja nuk ka veturë zyrtare.

**Filkizare Dema-** kryeinfermiere- Një takim i tillë i mirëseardhur,, falënderojmë komunën, kryetarin si dhe sektorin e prokurimit për përkrahjen e vazhdueshme për shëndetësinë. Një kënaqësi e madhe kur tashmë disa probleme janë zgjidhur si shtimi i stafit në punë, orari i barnatoreve, barnat esenciale, ndërsa kërkoj që të bëhet plotësimi i autoparkut, një mirëmbajtëse të objektit, si dhe dy pika të reja për laborator.

**Ekrem Dullovi** zv drejtor: Kur do të hapet ambulanta e re në Doganaj?

Të gjithë ata që bënë pyetje dhe kërkesa morën përgjigje nga ana e drejtorit si dhe diskutuan në lidhje me temat e ngritura në debat.



Procesmbajtësi  
**Fatlume Guri Selimi**